



Simboli i Komunës

SHTYPI DITOR PËR SUHAREKË

BOTA SOT**KOHA DITORE****ZËRI****PRISHTINA POST****KOSOVA SOT****LAJM****EXPRESS**

Kosova sot, fq 23
E enjte, 16 shtator 2010

Donacion për shkollën “7 Marsi”

Shkollës fillore dhe të mesme të ulët “7 Marsi” në Therandë deri më tani i ka munguar kabineti i informatikës dhe nxënësit lëndën e Informatikës e kanë mësuar pothuaj vetëm në teori. Inxhinieri i elektroteknikës nga Franca, z. Julian Zaug, për nxënësit e kësaj shkolle solli donacion kabinetin e kompletuar të informatikës me 20 kompjuterë, me pajisjen përcjellëse, në vlerë prej 6000 euro dhe personalisht po e bën instalimin e pajisjeve....

Autor : Rahman Rexhaj

Kosova sot, fq. 24

Ndërtohen dy ambulanca dhe Shtëpia e pleqve

Në komunën e Therandës shërbimi shëndetësor është i organizuar nëpërmjet Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, në kuadër të së cilës funksionojnë gjashtë qendra të mjekësisë familjare në fshatrat Mushtisht, Studençan, Gjinor, Duhël, Mohlan dhe Bukosh dhe në pesë ambulanca: në Grejkoc, Sopi, Nishor, Samadraxhë dhe Dobërdelan....

Autor : Rahman Rexhaj

Kosova sot, fq 43

Njoftim për kontratë- Ritender

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues : “Ndërtimi i kulmit mbi ndërtesën e Kadastrit”

Afati i fundit për pranimin e kërkesave për dosjen e tenderit/dokumenteve para-kualifikuese: data: 23.09.2010 deri ora: 15h Zyra e prokurimit nr 12

Afati kohor për pranimin (dorëzimin) e tenderëve/kërkesave për pjesëmarrje: data: 27.09.2010 ora: 13.30h vendi: Zyra pritëse nr 1

Takimi për hapjen e tenderëve: data: 27.09.2010 ora: 14 vendi: Salla e bordit përball zyrës së Prokurimit

Foto Lajm nga
Theranda

